



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

PËR KOHË TË PACAKTUAR

Neni 1 Palët kontraktuese

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ne tekstin e mëtejshëm “marrëveshja” është lidhur mbi bazën e vullnetit të lirë të palëve si dhe bazuar ne dispozitat ligjore te Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve (tutje referuar si LMD), kjo marrëveshje lidhet sot më datë 29.01.2024, në mes të:

1. “Optika Moda” SH.P.K. me numër unik identifikues te biznesit 810836554, me seli ne rrugën “Ilaz Kodra” p.n., ne Prishtine, te cilën e përfaqëson z. Basri Asllani, tutje referuar si “ofruesi shërbimeve”, dhe
2. Sindikatës e Pavarur e Doganës së Kosovës - SDPK , me numër fiskal 60243367, me seli ne rrugën :Rexhep Krasniqi” 10000 Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Ali VITIJA-Kryetar, me tutje “marrësi i shërbimeve”.

Se bashku referuar si “Palët”, dakordohen si ne vijim:

Neni 2 Qëllimi

2.1 Palët bien dakord te bashkëpunojnë me qëllim qe anëtarët e Sindikatës së Pavarur të Doganës së Kosovës marrin shërbimet e ofruara nga “Optika Moda” SH.P.K.

Neni 3 Objekti

3.1. Objekti i kësaj kontrate mes Palëve është ofrimi i shërbimeve qe kryen “Optika Moda” SH.P.K. Te gjitha shërbimet për kujdesin e syve: si kontrolla mjekësore për sy me aparaturën më të sofistikuar, ekzaminimin e syrit, përcaktimin e dioptrisë dhe ofrimit te syzeve. Të gjitha këto shërbime për anëtarët e Sindikatës së Pavarur të Doganës së Kosovës dhe familjareve te tyre (prindërit, bashkëshorti/ës dhe fëmijëve)

Neni 4 Kohëzgjatja

4.1. Palët me nënshkrimin e kësaj Kontrate, krijojnë marrëveshje të bashkëpunimit për periudhe të pa caktuar.



Sindikata e Pavarur e Doganave të Kosovës
Nezavisni Sindikat Carine Kosova
Kosovo Customs Independent Union

Neni 5

Shërbimet e ofruara

5.1. Te gjitha shërbimet për kujdesin e syve të përfshira si më poshtë:

- a) Kontrolla mjekësore për sy me aparaturën me te sofistikuuar, ekzaminimin e syrit, përcaktimin e dioptrisë ofrohen pa pagese për te gjithë anëtarët Sindikatës së Pavarur të Doganës së Kosovës dhe anëtarët e familjes se ngushtë,
- b) Anëtarët Sindikatës së Pavarur të Doganës së Kosovës gjithashtu përfitojnë zbritje në syze dioptrike 50% nga vlera e tyre, ndërsa anëtarët e familjes së ngushtë 30%.
- c) Anëtarët Sindikatës së Pavarur të Doganës së Kosovës gjithashtu përfitojnë zbritje ne syze të diellit si dhe në lente kontakti dhe xhama dioptrik zbritje prej 35%, ndërsa anëtarët e familjes së ngushtë 20%.

5.2. Zbritja për anëtarët e Sindikatës së Pavarur të Doganës së Kosovës aplikohet pasi që të paraqesin kartelën identifikuese ose vërtetimin nga sindikata e tyre qe dëshmon se janë anëtarë te sindikatës.

Neni 6

Shkëputja e kontratës

6.1 Secila Palë mund ta shkëpusë këtë marrëveshje me mirëkuptim, me një njoftim paraprak prej 30 ditësh.

Neni 7

Te dhëna personale

7.1. Klienti nëpërmjet kësaj Kontrate pranon shprehimisht qe ofruesi i shërbimeve mund te mbledhë, përpunojë, përdorë, transferoje dhe komunikojë te dhënat personale te klientit ne përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e te Dhënave personale.

Neni 8

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE KONTRAKTUESE

8.1. Palët kontraktuese u dakorduan qe pas fillimi te bashkëpunimit do te mbajnë te informuar secila palë për palën tjetër lidhur me ekzekutimin e kësaj kontrate.

8.2. Secila pale e kësaj marrëveshje, si nikoqir i mire do te kujdeset ne zbatimin e marrëveshjes me mirëbesim dhe sipas parimeve te mira ekonomike.



Neni 9

Zgjidhja e Kontesteve dhe Ligji i Aplikueshëm

9.1. Mosmarrëveshjet eventuale ndërmjet palëve lidhur me implementimin e kësaj kontrate duhet të zgjidhen me mirëbesim dhe metoda alternative, në të kundërtën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve eventuale është Gjykata Themelore në Prishtinë. Palët obligohen që para inicimit të procedurës në Gjykatë të provojnë të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre në procedurë të ndërmjetësimit, në përputhje me Ligjin e Punës dhe Ligjin për Ndërmjetësimin.

Neni 10

Shprehja e vullnetit të lirë dhe të tjera

10.1. Palët kontraktuese konfirmojnë se pasi i kanë lexuar të gjitha nenet e kësaj kontrate dhënë shprehje të vullnetit të lirë e nënshkruajnë këtë kontratë pa imponime apo ndikime të jashtëm të çfarëdo lloji, e këtë e vërtetojnë me nënshkrimet e tyre.

10.2. Palët kontraktuese me vullnetin e tyre mund të ndryshojnë dispozita të caktuara të kësaj kontrate në shkrim (aneks kontratë).

Neni 11

KOPJET DHE NDRYSHIMET

11.1. Kjo marrëveshje është hartuar dhe nënshkruar në 2 (dy) kopje identike, nga 1 (një) kopje për secilën palë. Çdo ndryshim i dispozitave të kësaj marrëveshjeje është i vlefshëm vetëm nëse është bërë në formë të shkruar dhe është nënshkruar nga të dy palët.

PALËT KONTRAKTUESE

OFRUESI I SHËRBIMIT

Optika Moda SH.P.K.


z. Basri Asllani



MARRËSI I SHËRBIMIT

Sindikata e Pavarur e Doganës së Kosovës


z. Ali Vitija - Kryetar

